


## Grupi i Punës së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit EUROSAT/WGEA organizon e-seminarin në Ditën Botërore të Ujit

Dita Botërore e Ujit është një ditë globale e Kombeve të Bashkuara që festohet çdo vit më 22 mars për të rritur ndërgjegjësimin për vlerën e ujit. Sekretariati i EUROSAT WGEA, në emër të z. Marian Banaś, President i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, ftoi përfaqësues të SAT-ve nga vende të ndryshme për pjesëmarrje në Seminarin e Ujit të EWGEA më 22 mars 2024, i cili u zhvillua online në CISCO WebEx.



Gjatë seminarit u prezantua Objektivi i Zhvillimit Strategjik nr. 6 dhe nën objektivi i tij nr. 6.5 – “*Deri në vitin 2030, të implementohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore në të gjitha nivelet, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar sipas rastit*”. Ky objektivi konsiston në promovimin, zhvillimin dhe menaxhimin e koordinuar të ujit, tokës dhe burimeve të lidhura me to, në mënyrë që të maksimizohet rezultati ekonomik dhe mirëqenia sociale në mënyrë të barabartë pa çënuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve vitale. Ky prezantim u krye nga ekspertët e Institutit për Meteorologjinë dhe Menaxhimin e Ujërave – Instituti Kombëtar i Kërkimeve (Poloni) - PhD Wiwiana Szalińska dhe PhD Tomasz Walczykiewicz.

Gjatë sesionit të dytë u diskutua mbi indikatorin 6.5.1 – *Menaxhimi i ujit*, ku shkalla e këtij treguesi matet në një interval nga 0 – 100%, përsa i përket fazave të ndryshme të zhvillimit dhe zbatimit të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore. Ky tregues bazohet në një instrument ekzistues monitorimi i cili është zhvilluar nga UNEP-DHI dhe monitoron aspekte të ndryshme të kuadrit të politikave për menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Ky sesion i seminarit u prezantua nga Paul Glennie, Këshilltar i Lartë Teknik nga Qendra UNEP-DHI për Ujin dhe Mjedisin.

Në vijim u bë një prezantim mbi indikatorin 6.5.2 *Matja e progresit drejt bashkëpunimit për ujërat ndërkufitare*, i cili gjurmon përqindjen e zonës së basenit ndërkufitar brenda një vendi që ka një marrëveshje operationale për bashkëpunimin ujor, e cila mund të jetë një traktat, konventë apo marrëveshje dy ose shumëpalëshe mes vendeve bregdetare që ofron një kornizë për bashkëpunim. Kjo pjesë e seminarit u prezantua nga Iulia Trombitcaia, Zyrtare për Çështjet Mjedisore, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) dhe Tatiana Dmitrieva, Zyrtare e Projektit në Seksionin e Qëndrueshmërisë së Ujërave nëntokësore dhe Bashkëpunimit Ujor të Programit Ndërqeveritar Hidrologjik të UNESCO-s (UNESCO-IHP).

Në pjesën e fundit të seminarit u diskutua mbi kursin masiv të hapur me temë “Auditimi i Çështjeve të Ujit”, fokusi i të cilit ishte prezantimi i kompleksitetit mbi temat që lidhen me ujin duke nisur nga cikli i ujit, problemet me menaxhimin e rregullimit të ujit, si dhe mundësitë për auditimin e ndikimeve mjedisore dhe të qëndrueshmërisë së ujit duke përdorur metodat e auditimit të performancës. Ujërat sipërfaqësore dhe bregdetare, si dhe ujërat nëntokësore ishin kryesisht në fokus të kursit, me përjashtim të çështjeve specifike të mjedisit detar dhe biodiversitetit. Sesioni i fundit u prezantua nga Tuuli Rasso audituese në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Estonisë.

KLSH në këtë seminar u përfaqësua nga audituesit, Megi Peza, Jupitern Malaj dhe Enea Sali.